STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 18 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE ME SHUME SE 700 KESHILLUES TE 'PROJEKTIT SHPRESA' JANE DERGUAR PER TE SIGURUAR KESHILLIM TE KRIZES NE ZONAT E GODITURA ME RENDE NGA URGANI SENDI (SANDY)

Më shumë se 200,000 banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) pritet të marrin shërbime përmes programit

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se përmes programit 'Projekti Shpresa,' një Program të Ndihmës për Këshillimin e Krizës dhe Trainimin, më shumë se 700 këshillues janë dërguar në komunitetet e goditura më rëndë nga Uragani Sendi (Sandy) për të siguruar shërbime të kujdesit mendor për banorët e prekur të Nju Jorkut (New Yorkers). Zyra Shtetërore e Shëndetit Mendor (The State Office of Mental Health) (OMH) vlerëson se më shumë se 200,000 individë në Qytetin e Nju Jorkut (New York City), Long Ajlënd (Long Island) dhe Luginën e Hadsonit të Poshtëm (Lower Hudson Valley) do të marrin takime, këshillime të krizës dhe shërbime edukative përmes programit.

Deri më 13 dhjetor 2012, OMH ka punësuar, trainuar dhe dërguar 717 këshillues të krizës në Qytetin e Nju Jorkut (New York City), Long Ajlënd (Long Island) dhe Qarkun Uestçestër (Westchester County). Agjencia pret të punësojë dhe të dërgojë gjithsej më shumë 900 këshillues për Projektin Shpresa.

“Ndikimi shkatërrues i Uraganit Sendi (Sandy) vazhdon të ndjehet anembanë shtetit,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Për shumë banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) që janë duke rindërtuar dhe duke u përpjekur të kthejnë jetën e tyre në normalitet, këto janë kohëra shumë të vështira dhe plot stres. Si reagim, Projekti Shpresa do të vazhdojë të zgjerohet dhe do të sigurojë shërbimet e tij të këshillimit të krizës, në mënyrë që komunitetet e goditura më rëndë të mund të rimëkëmben dhe të rindërtohen sa më shpejt që të jetë e mundur.”

Muajin e kaluar, Shteti mori një fond prej 8.2 milionë dollarë nga FEMA për të financuar Projektin Shpresa. Programi synon të ndihmojë viktimat e Uraganit Sendi (Sandy) të kuptojnë se, në shumicën e rasteve, reagimet emocionale të tyre janë normale. Këshilluesit e krizës në program përdorin praktikat e vërtetuara të Ndihmës së Parë Psikologjike, e cila përdor kontaktin mbështetur mbi marrëdhënien për të siguruar mjedise të sigurta dhe të rehatshme për viktimat që të rimëkëmben dhe të marrin informacion, ndihmë dhe referime. Projekti Shpresa synon të ndihmojë banorët e prekur të Nju Jorkut (New Yorkers) që të kthehen në nivelet e tyre të funksionimit dhe të kujdesit mendor përpara stuhisë.

Me financimin federal, OMH ka punësuar dhe trainuar këshillues të krizës për të punuar në zonat e prekura. Këta këshillues do të vazhdojnë të zhvillojnë takime në qendrat e komunitetit dhe të shkojnë derë më derë për të siguruar shërbime, të cilat përfshijnë këshillim të krizës, ndihmë emocionale, teknika të përballimit dhe pakësimit të stresit, të japin referime dhe informacion mbi burimet që kanë lidhje me krizën.

Përveç kësaj, 85 punonjës të OMH-së udhëtuan për në Qendrat e Rimëkëmbjes nga Katastrofa për të siguruar shërbime të kujdesit mendor gjatë Uraganit Sendi (Sandy). Në qarqet Naso (Nassau), Safolk (Suffolk), Roklënd (Rockland) dhe Oranzh (Orange), më shumë se 20,000 banorë të Nju Jorkut (New Yorkers) morën ndihmë.

Banorët e Shtetit të Nju Jorkut (New York State) që përjetojnë shqetësim emocional si rezultat i katastrofës mund të përdorin këshillimin konfidencial të krizës gjatë gjithë kohës duke telefonuar LifeNet në 800-543-3638.

Të rriturit me vuajtje të vazhdueshme nga një traumë mund të shfaqin shenja irritimi, përqëndrim të keq, gjendje shpirtërore të keqe e mungesë shprese, izolim, shkurajim dhe pasiguri për të ardhmen, brengosje të vazhdueshme për humbjet e tyre, makthe dhe imazhe të së kaluarës, probleme shëndetësore të reja ose në përkeqësim dhe abuzim të alkoolit, duhanit dhe drogës. Fëmijët, veçanërisht ata të ndarë nga familjet e tyre, që humbën familjen ose miqtë, ose që u desh të largohen ose rivendosen mund të krijojë reagime të vazhdueshme traumatike dhe të veprojnë si më të vegjël sesa mosha e tyre, të mos shkojnë mire në shkollë, të jenë të izoluar, të përfshihen në sjellje të rrezikshme dhe madje të kenë problem me ligjin.

Ata që përjetojnë ndonjë prej shenjave të mësipërme të traumës inkurajohen të marrin ndihmë menjëherë, në mënyrë që të mund të rimëkëmben dhe të rindërtojnë jetën e tyre shpejt.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418